

VENDIM
Nr. 75, datë 7.6.2016

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E PLANIT TË INVESTIMEVE
PËR VITIN 2016 PËR KESH SHA**

Në mbështetje të nenit 16; nenit 109, pika 5; nenit 110, pika 2, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhi-mit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”; gjithashtu, dhe rregullores “Për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin nr. 62, datë 15.9.2009; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 7.6.2016, mbasi shqyrtoi relacionin për fillimin e procedurës për miratimin e Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “KESH” sh.a., të përgatitur nga grupi i punës,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për miratimin Planit të Investimeve për vitin 2016 për kompaninë “KESH” sh.a.
 2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorëve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti